

Njoftim për shtyp i Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 13 Nëntor 2020

Sot në datën 13.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si vijon:

Në përfundim të procedurave të verifikimit të thelluar të kushteve dhe kriterëve ligjore, pasurisë dhe figurës, të kandidatit të katërt për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, z. Darjel Sina, Këshilli vendosi kualifikimin e tij si dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, pas kryerjes së verifikimit të plotë të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, Këshilli vendosi kualifikimin e kandidatit z. Eriol Roshi dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit.